



## Vaksinimet

### A do të sëmurem nga vakcina?

- Jo, nuk do të infektoheni me COVID-19 nga vakcina. Mund t'ju shfaqen disa efekte anësore pas marrjes së dozës së parë ose të dytë, por këto simptoma pritet të zhduken brenda disa ditëve. Në të kundërt, telefononi mjekun tuaj.
- Tek efektet e zakonshme anësore përfshihen pezmatimi i krahut (në vendin e injeksionit), ethet, dhimbja muskulore, dhimbja e kokës.

### A më duhet të mbaj prapë maskë nëse bëj vaksinën?

- Po. Duke qenë se nuk janë vaksinuar të gjithë dhe duke qenë se ka ende variante të reja ngjitëse të COVID-19, duhet të vazhdoni të mbani maskë, të ruani distancën sociale dhe të lani duart.

### A do t'i përdorin shërbimet e emigracionit informacionet që jap?

- Jo. Asnjë nga informacionet që na jepni nuk do të përdoret nga shërbimet e emigracionit ose qeveria për t'ju gjurmuar juve, anëtarët e familjes suaj ose fqinjët tuaj. Informacioni na ndihmon të dimë se kush e ka bërë tashmë vaksinën dhe kush nuk ka mundur ta marrë ende.

*Nuk ju nevojitet makinë për testimin ose vaksinimet Nuk është e nevojshme të jeni pacient i LCHC-së apo të keni sigurim shëndetësor.*

### Planifikoni takimin tuaj për vaksinën:



I hapur për të gjithë rezidentët e Masaçusetsit  
<https://www.lchcnet.org/covid-19-vaccine-scheduling>

### Më shumë informacion:

<https://www.lchcnet.org/covid-19-vaccine-information>

### Klinika e lëvizshme e vaksinimit: Po i sjellim vaksinat pranë jush!



<https://www.lchcnet.org/mobile-vaccination-program>

- Për bizneset, organizatat me bazë në komunitet, vendet e adhurimit/kultit
- Në vendndodhjen tuaj ose në bashkëpunim me një organizatë tjetër
- Jemi të përkushtuar që ta bëjmë të suksesshëm bashkëpunimin me organizatën tuaj

## Testimi

### Pse duhet të testohem?

- Gjurmimi i rasteve pozitive të COVID-19 do të na ndihmojë ta rihapim komunitetin tonë në mënyrë të sigurt dhe të mbrojmë të gjithë njerëzit tanë të dashur
- Furnizimi me vakcina është i kufizuar dhe jo çdokush e ka bërë vaksinën deri tani
- Vaksinat nuk janë tamam 100% efikase, edhe pse janë gjithsesi një ndihmë shumë e madhe dhe janë shumë të sigurta

- ✓ Të gjithë mund të testohen, si të rriturit, ashtu edhe fëmijët
- ✓ Nuk është e nevojshme të keni sigurim shëndetësor
- ✓ Nuk do t'ju pyesin në lidhje me statusin tuaj të emigrantit

### Kontrolloni për orare testimi falas:

<https://www.lchcnet.org/covid-19-testing-information>

*Mirëpresim testimet pa planifikim.*

